



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	02-04-2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJEN	1606/2021		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.105/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.105/2021 të datës 26.02.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Balshajve", fshati Milloshevë, Komuna e Obiliqit, në çështjen administrative-juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 02.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.105/2021, e datës 26.02.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Vendimi KA.nr.02/2021 i datës 14.01.2021 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe lënda kthehet në rishqyrtim të Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor.
- I. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të bëjë zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Zyrtar për Përkthime pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me datë 26.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 840/2021, të regjistruar me A.nr. 105/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Numër KA.nr.02/2021 të datës 14.01.2021.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 04.03.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa me datë 15.03.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës të datës 25.02.2021 me numër prot:840/2021; Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me Numër KA.nr.02/2021 të datës 14.01.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.03.2021 të protokolluar me numër: 968/2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 15.03.2021 me numër protokoli:1146/2021; Vendimin e Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër KD: 10/2020 të datës 30.10.2020; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 21.12.2020; Shkresën me shënim Dosja e pushimit vjetor-shtojca nr.2 për ankuesin Aktvendimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës me numër GJA.nr.19/2020 të datës 30.07.2020; Akt Emërimit e ankuesit me numër Ref: DS-407/2020 të datës 01.07.2020; Flete kthesën e datës 24.11.2020; Flete kthesën e datës 27.11.2020; Flete dërgesën e datës 30.11.2020; Shkresën e datës 28.10.2020; Thirrjen për shqyrtimin kryesor For-obr.nr.13; Marrëveshjen për transferimin e nëpunësve civil ndërmjet Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Akademisë së Drejtësisë e datës 30.06.2020 me numër:01/591; Njoftimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë GJA.nr.148/2020 të datës 08.10.2020 për iniciimin e procedurës disiplinore; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "zyrtar për përkthime"; E-mailin e datës 18.03.2021 me numër 1226/2021; Fletë kthesën e datës 09.02.2021 për dërgimin e vendimit KA.nr.02/2021 tek ankuesi; Shkresën e datës 05.02.2021; Dëftesën e postës për pranimin e dërgesës e datës 18.01.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shtjelluar dhe analizuar provat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe lënda kthehet në rishqyrtim pranë Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune në shërbimin civil, fillimisht pranë Akademisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, ndërsa sipas pëlqimit të tij, me Marrëveshjen për Transferimin e Nëpunësve Civil të datës 30.06.2020 me numër 01/591 ndërmjet Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Akademisë së Drejtësisë, ankuesi nga data 01.07.2020 është transferuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Sipas Akt Emërimit të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 30.06.2020 i njëjti ushtron pozitën Zyrtar për përkthime.

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës bazuar në shkresën GJA.Nr.148/08.10.2020, të Administratores së Gjykatës Themelore në Mitrovicë për iniciim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, me vendimin numër KD 10/2020 të datës 30.10.2020, ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 13 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbim Civilë si dhe nenin 59 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civilë, duke i shqiptuar masën disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës"

Ankuesi kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor, me datë 21.12.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili me Vendimin numër KA.nr.02/2021 të datës 14.01.2021, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit të datës 21.12.2020, ndërsa ka lenë në fuqi Vendim me numër KD 10/2020 të datës 30.10.2020 të Komisionit Disiplinor.



Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë kundër vendimit të KZAK-së numër KA.nr.02/2021 të datës 14.01.2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë, me perëndimet se vendimi është nxjerrë me shkelje të ligjit material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Lidhur me shqyrtimin e pretendime ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 63 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj*, si dhe nenin 64 paragrafi 1 dhe 3 ku është përcaktuar se: *1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji. 3. Nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se nëpunësi civil është përgjegjës për çdo veprim apo mosveprim të tij, i cili bie ndesh me parimet dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civilë të paracaktuara me kreun VII të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.*

Përkitazi me ndarjen e shkeljeve disiplinore, Kolegji ju referua nenit 4 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ku shprehimisht është përcaktuar se shkeljet e punës ndahen në shkelje të lehta dhe shkelje të rënda-serioze, ndërsa lidhur me masat disiplinore që mund të shqiptohen ndaj nëpunësve civil për shkelje të rënda-serioze Kolegji ju referua nenit 8 të kësaj rregulloreje, me të cilin është përcaktuar se: *nëpunësit civil, mund t'i shqiptohen këto masa disiplinore: 1.1 pezullimi parandalues me pagesë deri në (3) muaj në pritje të një hetimi, i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion; 1.2 pezullimi i ushtrimit të detyrave dhe ndalimi i 1/3 së rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.3 largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; 1.4 ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension; dhe 1.5 pensionim i parakohshëm i nëpunësve civil, të cilëve u kanë mbetur edhe dy (2) vjet deri në datën e pensionimit,*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka vlerësuar se Komisioni Disiplinor në procedurë disiplinore ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike përkitazi me vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore të ankuesit, i cili pa njoftimin dhe autorizimin e eprorit të tij ka munguar me shumë se dy ditë pune respektivisht pas pushimit mjekësor të shfrytëzuar nga data 14.09.2020 deri 02.10.2020, nuk është paraqit në punë dhe se për këtë mungesë nuk ka njoftuar organin e punësimit përkatësisht udhëheqësin e tij. Po ashtu Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor drejtë ka cilësuar veprimet e ankuesit si shkelje e rëndë disiplinore sipas nenit 6 paragrafi 1 nen paragrafi 13 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbim Civil me të cilin nen është përcaktuar se: *"Shkelje të rënda-serioze konsiderohen: 1.13. mos informimi dhe mungesa e paarsyeshme në punë për (dy) ditë pune të njëpasnjëshme.*

Mirëpo Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës", nuk ka marrë parasysh faktin se masat disiplinore zbatohen në mënyra graduale dhe në proporcion me shkeljen e kryer si dhe dëmin e shkaktuar me veprimin disiplinor të nëpunësit civil ashtu siç përcaktohet me nenin 66 paragrafi 1 të Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civilë ku thuhet: *Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor",* respektivisht Kolegji gjen se Komisioni Disiplinor nuk ka arrit të specifikojë dëmin e shkaktuar me sjelljen e ankuesit, nuk është marrë parasysh sjellja e mëparshme e ankuesit si dhe

rrethana se a është shqiptuar ndaj ankuesit me parë ndonjë masë disiplinore lidhur me shkelje të njëjta apo të tjera. Mbi këtë bazë, Kolegji për shqyrtimin e ankesës konstaton se Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, me të cilin është përcaktuar se: "Në përcaktimin e masave adekuate, komisioni duhet të ketë parasysh se qëllimi i procedurës disiplinore është të përmirësojë dhe inkurajojë sjellje të mirë dhe të dënojë sjelljen jo të mirë".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor, me Vendimin KA.nr.02/2021 të datës 14.01.2021, nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar dispozita material me rastin e refuzimit të ankesës së parashtruar kundër Vendimit KD 10/2020 të datës 30.10.2020 të Komisionit Disiplinor.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i detyruar që ta rishqyrtoj çështjen brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të këtij vendim si dhe rastin e vendosjes të marr parasysh të gjitha faktet dhe rekomandimet e theksuar më këtë vendim.

Bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A. Nr. 105/2021

**Flakron Gashi**

  
Zyrtar për Bashkëpunim Profesional

**Ardita Haxhnikaj Demi**

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
- Arkivit të KPMSHCK-s